

UDHËZIM

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË ANKESËS

I nderuar ankues,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Verifikimi i shkeljeve disiplinore dhe procedurat e hetimit disiplinor kryhen nga ana e ILD-së bazuar në procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky Udhëzim ka për qëllim të ndihmojë çdo person fizik apo juridik në plotësimin e saktë të Formularit të Ankesës.

Lutemi nga ana juaj, plotësimin e këtij Formulari duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme.

1. Bazuar në, pika 2, e nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, **ankesa juaj duhet të paraqitet pranë ILD-së në formë të shkruar.**
2. Ankesa juaj duhet të paraqitet sipas Formularit të Ankesës dhe mund të plotësohet me shkrim dore ose me kompjuter duke plotësuar rubrikat përkatëse.
3. Rubrikat me simbolin (*) janë të detyrueshme të plotësohen nga çdo person fizik apo juridik. Formulari i ankesës përveç rubrikave të detyrueshme përmban gjithashtu edhe rubrika opsionale për të cilat ju mund të mos jepni informacion.
4. Ju sqarojmë se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore **vetëm** ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Çdo subjekt tjetër ankimi është jashtë fushës së përgjegjësisë së Zyrës së ILD-së.

5. Informacioni i paraqitur në Formularin e Ankesës duhet të jetë i plotë, i shkruar qartë dhe me të gjithë informacionin e nevojshëm me qëllim verifikimin e tij nga ana e ILD-së.
6. Adresa e deklaruar nga ana juaj në Formularin e Ankesës, duhet të jetë e saktë dhe e plotë, pasi nëpërmjet saj ju do të njoftoheni mbi çdo veprim administrativ zyrtar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë trajtimit të ankesës tuaj.
7. Informacioni lidhur me, subjektin e ankesës, institucionin ku ai ushton veprimtarinë e tij si dhe faktet për shkeljet administrative të pretenduara duhet të jetë i plotë dhe i saktë.
8. Ju sjellim në vëmendje se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka autoritet:
 - a. të shqyrtojë çështje të cilat mund të kontrollohen nëpërmjet procedurave të ankimit në një gjykatë të shkallës më të lartë.
 - b. të ndikojë mbi Gjykatën apo Zyrën e Prokurorisë me qëllim që ju të përfitoni një rezultat të ndryshëm për çështjen tuaj. Nëse ju kërkoni të ndryshoni rezultatin e çështjes tuaj, duhet të diskutoni pa vonesë me një avokat.
9. Jeni të lutur, të bashkëlidhni të gjitha dokumentet e nevojshme, të cilat në gjykimin tuaj vërtetojnë deklarinimin e fakteve të paraqitura në ankesë. (Lutemi, jepni të dhëna se ku mund të gjendet informacioni i nevojshëm.)
10. Formulari i Ankesës i paraqitur pranë Zyrës së ILD-së duhet të ketë Emrin, Mbiemrin, datën dhe nënshkrimin tuaj. ILD do të respektojë në mënyrë rigorozë të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me konfidencialitetin e informacionit të paraqitur nga ana juaj.
11. Ankesa juaj (sipas Formularit standard) mund të dërgohet me postë ose dorazi në adresën zyrtare të ILD-së: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina 13, Tiranë, me Fax ose me postë elektornike në e-mail zyrtar: info@ild.al.
12. Ju bëjmë me dije se: Kërkesa për tërheqjen e ankesës nga ana juaj, nuk ndërpret procesin e trajtimit të saj nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
13. Formulari i Ankesës si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur saj nuk i kthehen ankuesit por janë pjesë e fondit të Arkivit të ILD-së.